



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GRUPI TEKNIK NDËRINSTITUCIONAL I PUNËS**

**“Strategjia për edukimin e publikut mbi
rrezikun që mbart pastrimi i parave dhe
financimi i terrorizimit në shoqërinë tonë”**

2025 - 2027

Miratur nga Grupi Teknik Ndërinstitucional i Punës

Dhjetor 2024

PËRMBAJTJA

Hyrje	3
Edukimi mbi rrezikun që mbart pastrimi i parave dhe financimi i terrorizmit.....	6
Qëllimi dhe objektivat e strategjisë	9
Roli i Grupit Teknik Ndërinstitucional të Punës	11
Roli i AIF në këtë proces	12
Efektet e keqinformimit	13
Përdorimi i Teknologjive të Reja (Fintech)	14
Kanalet e komunikimit dhe aktivitetet	18
Shembuj komunikimi me grupet specifike	19
Aneks I: Plan veprimi.....	22
Aneks II: Pyetësor.....	24

Hyrje

Parandalimi i pastrimit të parave dhe i financimit të terrorizmit, janë çështje që meritojnë vëmendje të veçantë!

Çfarë është pastrimi i parave? Pastrimi i parave është procesi i shndërrimit apo transferimit të pasurisë, fshehja ose maskimi i natyrës së të ardhurave, fitimi, posedimi ose përdorimi i pasurisë, duke ditur se ajo rrjedh nga vepra penale apo aktivitet kriminal; pjesëmarrja ose ndihma në lëvizjen e fondeve për t'i bërë të ardhurat të duken të ligjshme. Nëpërmjet këtij procesi personat e përfshirë në aktivitet kriminal fshehin origjinën e jashtëligjshme të fondeve dhe pasurisë së tyre për të shmangur dyshimin nga agjencitë e zbatimit të ligjit dhe për të penguar masat e ndërmarra nga organet kompetente për hetimin e tyre.

Çfarë është financimi i terrorizmit? Financimi i terrorizmit është tërësia e veprimeve që ka synim të financojë aktivitetet terroriste. Në rast se burimi i financimit të terroristëve vjen nga të ardhura të ligjshme, këta mund të kenë objektiv fshehjen e origjinës së fondeve, por ndërmarrin hapa për të fshehur destinacionin dhe qëllimin e tyre. Nga ana tjetër, në rastet kur terroristët dhe grupet terroriste financohen nga aktivitete të paligjshme, këta ndërmarrin veprime për të fshehur si origjinën e fondeve ashtu edhe destinacionin e tyre.

Parandalimi dhe zbulimi i pastrimit të parave mund të ndihmojë efektivisht në identifikimin e kriminelëve dhe terroristëve dhe mënyrën se si ata i kanë siguruar fondet e tyre. Zbatimi i teknikave të inteligjencës financiare dhe hetimit mund të ndihmojë në zbulimin dhe ndërprerjen e aktivitetit terrorist.

Fenomenet e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit janë trajtuar edhe nga një numër i madh organizmash ndërkombëtare, të cilat kanë vënë në lëvizje instrumente dhe mekanizma parandalues të shumëllojshme. Të ardhurat e jashtëligjshme që i nënshtrohen procesit të pastrimit mund të sigurohen nga aktivitetet kriminale, individuale ose të organizuara, nga veprimtari të jashtëligjshme, nga ryshfeti që marrin zyrtarët publikë të korruptuar si dhe nga një gamë e gjerë veprimtarish të tjera joligjore të entiteteve të biznesit publik e privat.

Pastrimi i parave dhe financimi i terrorizmit sjell pasoja negative në stabilitetin ekonomik financiar të vendit dhe në këtë kuadër masat parandaluese kanë një rol vendimtar në ndalimin e përhapjes së ndikimeve negative të kësaj vepre penale. Veprat e pastrimit të parave mund të kryhen nga çdo person, përfshirë edhe atë që ka kryer veprën penale mëmë/origjinuese, formë e cila njihet si vetë-pastrim, shpesh here kryhet edhe nga më shumë se një person.

Pastrimi i “produkteve të veprës penale” kryhet nëpërmjet:

- a) këmbimit ose transferimit të pasurisë me qëllim fshehjen ose mbulimin e origjinës së paligjshme të saj duke ditur se kjo pasuri është produkt i veprës penale ose i veprimtarisë kriminale;
- b) fshehjes ose mbulimit të natyrës së vërtetë, burimit, vendndodhjes, disponimit, zhvendosjes, pronësisë ose të drejtave në lidhje me pasurinë, duke ditur që kjo pasuri është produkt i veprës

penale ose i veprimtarisë kriminale;

c) fitimit të pronësisë, posedimit ose përdorimit të pasurisë, duke e ditur në çastin e marrjes në dorëzim të saj, që kjo pasuri është produkt i veprës penale ose i veprimtarisë kriminale;

ç) kryerjes së veprimeve financiare ose transaksioneve të copëzuara për shmangien nga raportimi, sipas legjislacionit për parandalimin e pastrimit të parave;

d) investimit në veprimtari ekonomike ose financiare të parave a sendeve, duke ditur se janë produkte të veprës penale ose veprimtarisë kriminale;

dh) këshillimit, ndihmës, nxitjes ose thirrjes publike për kryerjen e secilës prej veprave të përcaktuara më sipër;

Financimi i terrorizmit është dhënia ose grumbullimi i fondeve, me çdo mjet, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, me qëllimin që ato të përdoren ose duke ditur se ato do të përdoren, plotësisht ose pjesërisht:

a) për të kryer vepra me qëllime terroriste;

b) nga një organizatë terroriste;

c) nga një terrorist i vetëm;

Ndër treguesit kryesor të rasteve të pastrimit të parave dhe potencialisht edhe të financimit të terrorizmit mund të jenë:

- Transferta bankare me kompani të regjistruara në vende të konsideruara si “Parajsa Fiskale”;
- Investime në pasuri të paluajtshme nga persona të përfshirë në veprimtari kriminale;
- Transaksione jashtë profilin të shoqërive tregtare;
- Krijim dhe blerje kompanish për ushtrim të aktivitetit të huadhënies;
- Transferta ndërkombëtare në vlera të konsiderueshme;
- Qarkullim i shumave të larta në sistemin bankar pa të dhëna mbështetëse të besueshme për arsyen e kryerjes së transaksioneve;
- Transferta të kryera me vende me të cilat nuk ka arsye të dukshme për tu realizuar (si tregti, remitanca etj.);
- Pastrimi i parave ose financimi i terrorizmit përmes tregtisë;
- Fonde që rrjedhin nga aktivitet bamirësie që përdoren për financim të terrorizmit;
- Financimi i terrorizmit nëpërmjet fondeve me burim të ligjshëm;
- Përdorimi nga organizata terroriste i fondeve të jashtëligjshme.

Shqipëria, ashtu si çdo vend tjetër, nuk mund të jetë e imunizuar nga krimi dhe as nga pastrimi i parave që i shoqëron veprimtaritë kriminale. Rastet e praktikave të pastrimit të parave të zbuluara nga organet ligj zbatuese, mediat, etj., kanë detyruar autoritetet shtetërore të rishikojnë, herë pas here, kuadrin ligjor dhe rregullator, përfshirë masat përkatëse parandaluese.

Përveç hartimit të një kuadri ligjor të përditësuar, i cili i përgjigjet nivelit dhe shkallës së përhapjes së fenomenit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, janë ngritur dhe funksionojnë institucionet përgjegjëse dhe është institucionalizuar një proces permanent që

mundëson reflektimin në kohë të të gjithë ndryshimeve të kuadrit ndërkombëtar, siç janë standardet dhe metodologjia e FATF, por edhe direktivat e BE-së, etj.

Lufta kundër pastrimit të parave (PP) dhe financimit të terrorizmit (FT) vazhdon të jetë e një rëndësie të posaçme për vendin tonë dhe Shqipëria mbetet e përkushtuar ndaj parandalimit, zbulimit dhe ndjekjes penale të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit PP/FT, duke vendosur një kuadër të përshtatshëm ligjor dhe institucional. Lufta kundër PP/FT ka për qëllim të mbrojë sistemin financiar, të eliminojë burimet në dispozicion të terroristëve dhe t'u minimizojë sa më shumë personave të përfshirë në krime përfitimin nga veprimet e tyre kriminale.

Sidoqoftë, si në çdo fushë tjetër, parandalimi i pastrimit të parave dhe i financimit të terrorizmit nuk lidhet aq me cilësinë e kuadrit ligjor, sa lidhet me cilësinë e zbatimit të kërkesave ligjore e rregullatore. Ndër masat shtesë që nevojiten të merren është edhe rritja e shkallës së ndërgjegjësimit të opinionit publik për këto fenomene dhe pasojat negative të tyre, të cilat gjithnjë e më shumë përbëjnë çështje globale.

Duke pasur në konsideratë qëllimin kryesor të **Strategjisë Kombëtare për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit 2024 - 2030**¹ dhe katër prioritetet e kësaj strategjie², vlerësojmë se në funksion të përmbushjes së prioritetit të parë që lidhet me përmirësimin e politik bërjes dhe koordinimit, ka vend të ndalemi e të fokusohemi në hartimin e një strategjie që lidhet me edukimin e publikut mbi rrezikun që mbart pastrimi i parave dhe financimi i terrorizmit në shoqërinë tonë.

Prioritetet e strategjisë janë grupuar në gjashtë objektiva:

1. Përmirësimi i kuadrit rregullator dhe forcimi i koordinimit ndërinstitucional;
2. Rritja e mëtejshme e efektivitetit të sistemit parandalues;
3. Përmirësimi i efikasitetit operacional të organeve ligj zbatuese dhe agjencive të tjera në luftën kundër PP/FT;
4. Përdorimi dhe shfrytëzimi i inovacioneve teknologjike duke zvogëluar rreziqet;
5. Rritja e efektivitetit të sistemit mbikëqyrës;
6. Forcimi i bashkëpunimit ndërkombëtar.

Nëpërmjet zbatimit të kësaj strategjie synohet konsolidimi i mëtejshëm i regjimit Shqiptar i PP/FT në përputhje me ndryshimet në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar dhe kërcënimet përkatëse PP/FT.

¹ Qëllimi kryesor i Strategjisë është një ekonomi dinamike dhe sistem financiar i sigurtë dhe me integritet që zhvillohen ndër të tjera edhe duke përmirësuar dhe modernizuar regjimin kundër PP/FT, duke garantuar sigurinë e shtetasve shqiptarë dhe duke respektuar të drejtat dhe liritë individuale.

² Përmirësimi i politik bërjes dhe koordinimit; - Rritja e mëtejshme e efektivitetit operacional në parandalim; - Përmirësimi i efikasitetit operacional të organeve ligjzbatuese dhe agjencive të tjera të në luftën kundër PP/FT, si dhe - Përdorimi dhe shfrytëzimi i inovacioneve teknologjike duke zvogëluar rreziqet.

Për rrjedhojë, duke u ndalur te grupet që synojmë, objektivat që do arrijmë, kanalet e komunikimit dhe subjektet e angazhuara.

Edukimi mbi rrezikun që mbart pastrimi i parave dhe financimi i terrorizmit.

Vizioni i **Strategjisë Kombëtare për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit 2024 - 2030**, është zhvillimi i një sistemi të qëndrueshëm në Shqipëri për të luftuar ekonominë informale, financimin e terrorizmit dhe krimet tjera financiare, për t'u integruar në luftën rajonale dhe ndërkombëtare për të siguruar **paqen sociale, mirëqenien, dinjitetin, barazi dhe zhvillim të qëndrueshëm ekonomik** në përputhje me politikat e Qeverisë së Republikës së Shqipërisë.

Pastrimi i parave dëmton ekonominë e vendit në periudha afatgjata dhe **cënon integritetin e sistemit financiar** dhe të shtetit të së drejtës në përgjithësi.

Më poshtë shpjegohen shkurtimisht disa nga pasojat kryesore të pastrimit të parave:

Në ekonomi: Pastrimi i parave është problem si për tregjet financiare kryesore në botë dhe për tregjet në zhvillim pasi dëmton institucionet financiare që janë kritike për rritjen ekonomike. Ndërkohë që tregjet në zhvillim si Shqipëria zhvillojnë ekonominë dhe sektorët e tyre, ata gjithashtu bëhen gjithnjë e më shumë shënjestra për pastrimin e parave. Pastrimi i parave nxit krimin dhe korrupsionin dhe rrjedhimisht ngadalëson rritjen ekonomike dhe ul produktivitetin e ekonomisë reale. Efektet negative të pastrimit të parave në ekonomi mund të shfaqen në kërkesën për para, ritmet e rritjes, shpërndarjen e të ardhurave, kurset e këmbimit, dhe të ardhurat nga taksat.

Në qeverisje: Pastruesit e parave kërcënojnë cilësinë e qeverisjes së vendit nëpërmjet shtrembërimit të procedurave të privatizimit ose prokurimit publik. Organizatat kriminale mund të fitojnë mbi operatorët ekonomikë legjitime në përfitimin e kontratave publike apo blerjen e ndërmarrjeve shtetërore. Kur të ardhurat e jashtëligjshme investohen në këtë mënyrë, kriminelët rrisin potencialin e tyre për të kryer më shumë veprimtari kriminale apo korrupsion dhe e privojnë vendin nga ajo që duhet të jetë një ndërmarrje apo veprimtari e ligjshme taksapaguese, e bazuar në treg, që kryen një shërbim apo funksion publik në dobi të shoqërisë.

Sociale: Pastrimi i parave u lejon keqbërësve të zgjerojnë operacionet e tyre. Kjo rrit kostot e qeverisë në funksion të zbatimit të ligjit. Pastrimi i parave zhvendos fuqinë ekonomike dhe për rrjedhojë politike, nga qeveria, qytetarët dhe tregu te keqbërësit, çka mund të çojë në kapjen e një qeverie. Në përgjithësi, volumet e larta të pastrimit të parave sjellin reduktimin e shpenzimeve publike dhe investimeve strategjike në shëndetësi, edukim, shërbime sociale, infrastrukturë. Për rrjedhojë, mirëqenia e qytetarëve përkeqësohet.

Në zhvillim: Çdo vend me regjim të dobët të parandalimit të pastrimit të parave përballlet me pasoja negative për zhvillimin. Institucionet e huaja financiare mund të kufizojnë transaksionet

e tyre me institucionet vendase, të ndalojnë investimet e tyre, të rrisin koston e transaksioneve ose të ndërmarrin kontrolle shtesë. Bizneset dhe organizatat legjitime vendase mund të vuajnë nga akseset e kufizuara në tregjet financiare ose kosto më të larta për shkak të mbikëqyrjes të shtuar të pronësisë, organizimit dhe sistemeve të kontrollit. Si rezultat, çdo vend me regjim të dobët për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit (PPP/FT) tërheq më pak investime të huaja private. Për më tepër, ndihma shtetërore e huaj mund të ulet ndjeshëm.

Në siguri: Të perceptosh një vend si strehë të pastrimit të parave, ka të ngjarë të tërheqë më shumë keqbërës. Disa faktorë që çojnë në rritjen e krimit dhe korrupsionit janë zbatimi i dobët ose selektiv i dispozitave të parandalimit të pastrimit të parave dhe dënimet joefektive, përfshirë masat e konfiskimit dhe sekuestrimit të aseteve. Me qëllim për të lehtësuar procesin e pastrimit të parave, keqbërësit rrisin ryshfetin për zyrtarët publik, punonjësit dhe drejtuesit e institucioneve financiare, noterët dhe kontabilistët, ligjvënësit, autoritetet mbikëqyrëse, zyrtarët e policisë, prokurorët dhe gjykatat.

Në sektorin privat: Pastruesit e parave përdorin kompani guacka, të cilat janë kompani tregtare që duken të ligjshme por në fakt kontrollohen nga keqbërësit. Këto kompani guacka përziejnë fondet e jashtëligjshme me fonde legjitime për të fshehur burimin e të ardhurave. Duke përdorur kompani guackë dhe investime të tjera në kompani legjitime, të ardhurat nga pastrimi i parave mund të përdoren për të kontrolluar industri ose sektorë të rëndësishëm të ekonomisë së vendit. Kjo shkakton paqëndrueshmëri dhe shtrembërime artificiale të çmimeve të produkteve. Gjithashtu ofron një mënyrë për të shmangur taksimin dhe kështu privon vendin nga të ardhurat.

Mënyrat kryesore të komunikimit për Agjencinë e Inteligjencës Financiare do të jenë:

- Faqja zyrtare e internetit;
- Pjesëmarrja në seminare dhe konferenca kombëtare me subjektet e ligjit për parandalimin e pastrimit të parave dhe trajnimet përkatëse;
- Takimet me grupet e biznesit në funksion të ndërgjegjësimit për rreziqet që pastrimi i parave dhe financimi i terrorizmit ka për sistemin ekonomik financiar të Shqipërisë;
- Publikimi i udhëzuesve, tipologjive dhe treguesve të PPP/FT;
- Informimi i publikut të gjerë për punën e institucioneve;
- Publikimi i raporteve vjetore dhe raportimi në komisionet parlamentare për çështjet e sigurisë;
- Publikimi i pyetjeve më të shpeshta për subjektet e ligjit.

Kategori me risk të lartë për përfshirje në pastrim parash janë si më poshtë:

1. Individët rezident, skenarët e rrezikut më të lartë që lidhen me individët janë:
 - Blerje pasurish me burim të panjohur apo të pajustificuar;
 - Përfitimi i transfertave të shpeshta dhe në vlera të vogla nga individë pa një lidhje të qartë mes tyre;

- Depozitimi në llogari bankare të shumave cash me burim të panjohur;
 - Blerje pasurish të paluajtshme nën vlerë dhe rivlerësim brenda një kohe të shkurtër;
 - Veprime financiare (depozitim/ transferta/ investim në pasuri të paluajtshme/ luajtshme) nga persona të dyshuar si të përfshirë në veprimtari kriminale;
 - Investim në vlerë të lartë në pasuri të paluajtshme nëpërmjet përdorimit të personave të tretë.
2. Personat juridik rezident, përfaqësojnë numrin e dytë më të madh të subjekteve të përfshirë në aktivitetin e mundshëm të PP, kryesisht me burim të ardhurash nga krime në fushën tatimore, mashtrimi, krimi i organizuar, korrupsioni ku skenarët kryesorë përfshijnë:
- Vendosje të fondeve me origjinë të panjohur në qarkullimin real tregtar;
 - Investime në pasuri të paluajtshme në emër të shoqërisë ekzistuese të zotëruar nga persona të dyshuar si të përfshirë në veprimtari kriminale në vlera të pajustificuara me burime të ligjshme;
 - Përfitime të transfertave të larta në llogari biznesi të personit të dyshuar si i përfshirë në veprimtari kriminale nga shoqëri pa një lidhje të qartë mes shërbimit/mallit të ofruar dhe pagesës;
 - Përfshirje e një individi të vetëm në disa subjekte të cilat kanë të njëjtin objekt veprimtari apo të njëjtën adresë dhe kryerja e transaksione pa një lidhje të qartë midis palëve të transaksionit;
 - Transferta të dyshimta të përfituara në llogari të një shoqërie, që nuk ka aktivitet të mirëfilltë ekonomik;
 - Përdorimi i subjekteve juridike për përfitimin e transfertave nga jashtë nëpërmjet mashtrimit ku pjesa dërmuese e fondeve kanalizohen jashtë vendit dhe një pjesë tërhiqen cash.
3. Individët jo rezident, skenarët kryesorë të lidhur me këtë kategori janë:
- Krijimi dhe regjistrimi i subjekteve juridike rezidentë dhe përdorimi i llogarive të tyre bankare për marrjen apo dërgimin e transfertave nga/drejt juridiksioneve të ndryshme pa një lidhje të qartë me objektin e veprimtarisë të shoqërisë me dyshime të lidhura kryesisht me evazionin fiskal;
 - Realizimi i investimeve kryesisht rezidenciale pa një burim të qartë të ardhurave.
4. PEP Rezident³, për shkak të funksionit të tyre rastet e dyshuara të lidhura me PEP janë kur

³ Sipas nenit 2 pika 10 e ligjit PP/FT PEP do të konsiderohen: a)Individët, të cilët janë të detyruar të bëjnë deklarin e pasurive të tyre në përputhje me legjislacionin në fuqi për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë, me përjashtim të nëpunësve të nivelit të mesëm apo të ulët drejtues, pavarësisht nëse kanë detyrimin për deklarimin sipas legjislacionit në fuqi për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë; b)Individët, të cilët kanë ose kanë pasur funksione të rëndësishme si brenda vendit apo jashtë vendit në një qeveri dhe/ose në një shtet të huaj, të tillë si: kryetar shteti dhe/ose qeverie, ministra, zëvendësministra ose pozicione të ngjashme me to, anëtarë të Kuvendit ose organeve legjislative të ngjashme, politikanë të lartë, anëtarë të organeve drejtuese të partive politike, gjyqtarët e gjykatave të larta ose kushtetuese, si dhe çdo gjyqtar i një gjykate, ndaj vendimeve të së cilës nuk mund të ushtrohen mjetet e zakonshme të ankimit, anëtarët e organeve drejtuese të bankave qendrore, ambasadorët dhe të ngarkuarit me punë, si dhe oficerët me gradë madhore në Forcat e Armatosura, drejtuesit e lartë dhe/ose anëtarët e organeve drejtuese të shoqërive shtetërore, si dhe drejtorët, zëvendësdrejtorët ose anëtarët

vepra të origjinës vlerësohet të ketë qenë “Shpërdorim detyre/Korrupsion” dhe ndër skenarët kryesorë janë:

- Investime në vlera të larta në një biznes mbas mbarimit të detyrës (ish PEP) pa një burim të qartë të ardhurave apo edhe deklarimi i fitimeve të larta të menjëhershme nga një biznes i zotëruar nga një ish PEP;
- Qarkullim fondesh të larta në llogaritë individuale nga PEP deklaruar nga biznesi, por të pajustificuara nga të ardhurat e biznesit;
- Investime në pasuri të paluajtshme mbas mbarimit të detyrës pa një burim të qartë të ardhurave;
- Investime në pasuri nga PEP me vlerë të deklaruar nën çmim tregu;
- Emërim fillestar i administratorëve/përfaqësuesve ligjor por edhe e ortakëve të personave juridik pa të dhëna për aktivitet kriminal, por dukshëm pa përgatitje të duhur në kulturë ekonomike apo arsimore për të zotëruar ose zhvilluar aktivitete të tilla tregtare, që zotërohen *de facto* nga PEP dhe që më pas kalohen në emër të tyre. Një pjesë e këtyre shoqërive, në raste sporadike, janë të përfshira në fushën e prokurimeve publike.

Zbatimi i strategjisë synon:

- Komunikimin dhe bashkëpunimin e vazhdueshëm e të qëndrueshëm me institucionet publike dhe private, anëtare të Grupit Teknik Ndërinstitucional të Punës;
- Bashkëpunimin e ngushtë me subjektet e ligjit për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, shoqatat e tyre dhe autoritetet mbikëqyrëse në funksion të ndërgjegjësimit dhe rritjes së kapaciteteve parandaluese;
- Informimin e publikut të gjerë mbi punën e institucioneve të përfshira në parandalimin e pastrimit të parave, financimit të terrorizmit dhe goditjen e veprimtarisë kriminale;
- Përmirësimin e reputacionit të autoriteteve duke dhënë llogari për përpjekjet e bëra në luftën kundër korrupsionit dhe pastrimit të parave.

Qëllimi dhe objektivat e strategjisë

Objektivat e Strategjisë mbi edukimin e publikut, për rrezikun që mbart pastrimi i parave dhe financimi i terrorizmit në shoqërinë tonë **fokusohen në disa drejtime:**

Së pari, në sensibilizimin e mbarë opinionit publik mbi rrezikun që mbart pastrimi i parave dhe financimi i terrorizmit në shoqërinë tonë dhe kjo mund të arrihet me:

- **Publikimin e të dhënave** (dhe inkurajimin e publikimit të të dhënave nga çdo individ, institucion publik ose jo) **që lidhen me problemet** që kanë sektorë të ndryshëm të ekonomisë dhe të shoqërisë në tërësi, nga pastrimi i parave apo financimi i terrorizmit;

e bordit ose çdo pozicion tjetër i ngjashëm me to në një organizatë ndërkombëtare. Individët e përcaktuar në shkronjat “a” dhe “b” të kësaj pike do të konsiderohen “persona të ekspozuar politikisht” deri në 3 (tre) vjet pas largimit nga funksioni.

- **Inkurajimin e shkrimeve dhe publikimeve analitike apo problematike** nga studiues në këtë fushë;
- **Publikimi i rasteve dhe tipologjive të ndryshme që lidhen me pastrimin e parave** apo financimin e terrorizmit që janë siguruar nga hetimet penale apo hetimet pasurore;
- **Bashkëpunimi me media të ndryshme me qëllim programimin dhe zhvillimin e emisioneve televizive** mbi problematikat që mbart pastrimi i parave dhe financimi i terrorizimit.

Së dyti, mbi edukimin që duhet të marrin nxënësit dhe studentët gjatë formimit të tyre akademik dhe kjo mund të arrihet *(në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit apo dhe me fakultete të ndryshme)* me:

- **Vlerësimi i mundësive që kurrikulat e gjimnazeve apo kolegjeve në vendin tonë të kenë vend që të trajtojnë një ose disa tema** mbi rrezikun që mbart për ekonominë dhe zhvillimin e shtetit të së drejtës futja e parave të siguruar nga aktiviteti kriminal në ekonomi;
- **Vlerësimi i mundësive që kurrikula e fakulteteve të profileve që lidhen me ekonominë, drejtësinë, administrimin, politikën sociale, etj., të parashikojnë lëndë mësimore** apo grup të përqëndruar leksionesh apo temash, konkretisht ato që kanë të bëjnë me pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit *(ku të trajtohen gjerësisht çfarë është pastrimi i parave dhe financimi i terrorizmit, format e shfaqjes së tyre, rreziqet eventuale që sjellin për ekonominë dhe shoqërinë në tërësi, legjislacioni në fuqi, eksperiencat ndërkombëtare, operatorët dhe agjencitë përgjegjëse, subjektet, etj.)*;
- **Vlerësimi i mundësive që të orientohen programet e masterave nëpër fakultete që kanë profilet e të drejtës penale dhe krimit të organizuar**, që të fokusohen me lëndë apo grupe të përqëndruara leksionesh apo temash, konkretisht ato që kanë të bëjnë me pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit, duke bërë parashtrime të zgjeruara;
- **Nxitja e trajtimit të temave të kurseve apo diplomave të fakulteteve e masterave, apo dhe doktoratura** me tema që lidhen me pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit me qëllim që kjo fushë të ketë njohje dhe trajtim sa më të madh akademik.

Së treti, mbi trajnimin vazhdues të hetuesve, prokurorëve, gjykatësve e çdo subjekti tjetër që ka në fokus të tij evidentimin dhe ndjekjen e rasteve që lidhen me pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit *(në bashkëpunim me Shkollën e Magjistraturës, KLGJ, KLP-në, Prokurorinë e Përgjithshme, Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë, Tatimeve, Doganave, etj.)*.

Së katërti, trajnimin e komunitetit të biznesit *(në bashkëpunim me Dhomën Kombëtare të Tregtisë etj.)* dhe administratës publike *(bashkëpunim me Shkollën Shqiptare të Administratës Publike)* me qëllim identifikimin e veprimtarive të dyshimta financiare dhe përdorimin e materialeve edukative mbi parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit duke përdorur broshura, udhëzues etj..

Ky dokument shërben si një udhërrëfyes për informimin e të gjitha kategorive të subjekteve të ligjit, grupeve të interesit dhe publikut të gjerë për çështjet që lidhen me iniciativat ligjore në fushën PPP/FT, kërkesat rregullatore, dokumentet strategjike në fushën e PPP/FT dhe ecuria e zbatimit të tyre, vlerësimin kombëtar të rrezikut PPP/FT dhe vlerësimet sektoriale, praktikave më të mira dhe rekomandimet ndërkombëtare, detyrimet ligjore që subjektet kanë për raportim në autoritetet përgjegjëse, mbikëqyrja mbi bazën e rrezikut PP/FT dhe gjetjet përkatëse.

Roli i Grupit Teknik Ndërinstitucional të Punës

Me vendimin nr. 2, datë 26.12.2023 të Komitetit të Bashkërendimit të Luftës kundër Pastrimit të Parave (KBLKPP) është vendosur krijimi i Grupit Teknik Ndërinstitucional i Punës (GTNP). GTNP përbëhet nga përfaqësues të nivelit të lartë ose të mesëm drejtues nga secili institucion që ka anëtar në KBLKPP.

Grupi Teknik Ndërinstitucional i Punës, është një strukturë e posaçme dhe duhet të rrisë komunikimin midis institucioneve përgjegjëse dhe ato të sektorit privat për ta bërë më efikas, të prekshëm dhe të qëndrueshëm progresin në sistemin parandalues dhe të goditjes kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

Grupi Teknik, do të ketë rolin udhëheqës në koordinimin institucional për zbatim të rekomandimeve të Moneyval dhe përafrimin me legjislacionin e BE-së për parandalimin dhe goditjen e pastrimit të parave/financimit të terrorizmit, përfshirë angazhimin për përmbushjen e rekomandimeve të FATF, objektiva këto që kërkojnë angazhim serioz dhe të qenësishëm nga një serë institucionesh në vend, nëpërmjet:

- Koordinimit më efikas me Autoritetet Mbikëqyrëse dhe sektorin privat, në funksion të përmbushjes nga subjektet raportuese të çdo kategorie të masave parandaluese;
- Koordinimit me institucionet ligj zbatuese për identifikimin e risqeve më të mëdha për PP/FT;
- Koordinimit ndërinstitucional në aspekt të efikasitetit për implementim në kuadrin rregullativ ligjor të standardeve ndërkombëtare e ndryshimeve të tyre;
- Koordinimit me institucionet vendase në aspekt të trajnimeve për forcim të kapaciteteve për parandalim e luftës kundër PP/FT.

Grupi Teknik Ndërinstitucional i Punës, me angazhimin për mbështetje të plotë nga institucionet që përfaqësojnë, ngarkohet për:

- Hartimin e strategjisë kombëtare “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit 2024-2030” dhe planin e saj të veprimit.
- Ndjekjen e zbatimit të planit të veprimit për vitin 2024.
- Përgatitjen për raundin e 6-të të vlerësimit nga Komiteti Moneyval, përmes:
 - kryerjes së ushtrimeve simuluese për vlerësimin e efektivitetit sipas proceduarve përkatëse;
 - mbledhjes të të dhënave, informacionit, dhënien e kontributit dhe përfaqësimit në procesin e vlerësimit nga Moneyval.

Roli i AIF në këtë proces

Agjencia e Inteligjencës Financiare (AIF) funksionon si Drejtori e Përgjithshme në varësi të Ministrisë përgjegjëse për Financat dhe ushtron funksionet e autoritetit përgjegjës në përputhje me ligjin nr. 9917/2008 *“Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”* i ndryshuar. AIF drejtohet nga drejtori i përgjithshëm, i cili ka këto detyra dhe përgjegjësi:

- a) Drejton AIF-në dhe e përfaqëson atë në marrëdhënie me të tretët, brenda dhe jashtë vendit;
- b) Nënshkruan marrëveshje bashkëpunimi me institucione brenda vendit dhe me agjenci homologe të huaja apo organizma të tjerë jashtë vendit, që iu nënshtrohen detyrimeve të ngjashme të konfidencialitetit, në funksion të ushtrimit të detyrave e të funksioneve të saj;
- c) Informon në mënyrë periodike, me shkrim, për veprimtarinë e AIF-së Komitetin e Bashkërendimit të Luftës kundër Pastrimit të Parave;
- d) Drejton dhe orienton punën e Grupit Teknik Ndërinstitucional të Punës për parandalimin e pastrimit të parave, në kuadër të Komitetit të Bashkërendimit të Luftës kundër Pastrimit të Parave;
- dh) Bashkërendon punën për mbikëqyrjen e përmbushjes së detyrimeve të subjekteve të ligjit sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Misioni i AIF është mbrojtja e vendit nga krimi financiar dhe financimi i terrorizmit dhe të kontribuojmë në stabilitetin, integritetin, rritjen dhe qëndrueshmërinë e sistemit financiar në Shqipëri dhe të ekonomisë në përgjithësi, nëpërmjet zbulimit dhe goditjes së veprimtarive kriminale me anë të programeve tona rregullatore dhe të inteligjencës financiare.

Në zbatim të ligjit të sipërcituar Agjencia e Inteligjencës Financiare, ushtron një sërë funksionesh dhe detyrash, ndër të cilat:

- mbledh, administron, përpunon, analizon dhe shpërndan tek autoritetet kompetente të dhëna, raporte dhe informacione për çështjet e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit;
- organizon dhe merr pjesë, së bashku me institucionet publike dhe private, në veprimtaritë trajnuese, për parandalimin e pastrimit të parave dhe të financimit të terrorizmit, si dhe organizon ose merr pjesë në programe për të rritur ndërgjegjësimin e publikut;
- publikon brenda tremujorit të parë të çdo viti, raportin publik vjetor për vitin pararendës për veprimtarinë e autoritetit përgjegjës. Raporti duhet të përfshijë edhe statistika të hollësishme për origjinën e raporteve të marra dhe rezultatet e rasteve të parashtruara në prokurori;

Trajnimi i subjekteve të ligjit për çështjet e PP dhe FT, publikimi i Raportit Vjetor i cili përmban të dhëna të rëndësishme statistikore dhe cilësore por edhe dokumente të tjera të publikuara në faqen zyrtare të AIF (vlerësimi i riskut etj.) luajnë një rol të rëndësishëm në informimin dhe ndërgjegjësimin e publikut mbi rreziqet e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

Aktivitetet e komunikimit për AIF do të jenë të ndara në module dhe secili prej tyre aktivitete që aplikohen për grupe specifike të subjekteve të ligjit, grupeve të biznesit apo atyre të interesit si dhe publikut të gjerë. Komunikimi mund të jetë i drejtpërdrejtë (takim me universitetet) dhe online (mediatik).

Në vijim paraqiten në mënyrë të përmbledhur disa nga format e komunikimit:

- Publikime në lidhje me ndryshimet ligjore dhe detyrimet që duhet të zbatohen nga subjektet e ligjit;
- Përditësimi i pyetjeve më të shpeshta të subjekteve të ligjit;
- Publikimi i informacionit mbi aktivitetin institucional dhe rolin e tij në drejtim të parandalimit të pastrimit të parave;
- Informimi në lidhje me aktivitetin ndërkombëtar dhe ndikimin e tij në jetën ekonomike të vendit (psh vlerësimet ndërkombëtare nga Komiteti Moneyval i Këshillit të Evropës, Grupi i Posaçëm i Veprimit Financiar (FATF));
- Publikime në lidhje me aktivitetin dhe pjesëmarrjen e institucioneve në projektet ndërkombëtare që ofrojnë asistencën e tyre në Republikën e Shqipërisë;
- Informacion i përditësuar në lidhje me zbatimin e sanksioneve ndërkombëtare dhe komunikimi me subjektet e ligjit dhe publikun në përgjithësi;
- Publikimi i dokumenteve strategjik, planeve të veprimit dhe ecursisë së zbatimit të tyre;
- Informimi i publikut në lidhje me aktivitetet e bashkëpunimit ndërinstitutional, grupet e punës, inspektimet e përbashkëta etj.;
- Përgatitja e prezantimeve dhe materialeve shoqëruese për trajnimet që ofrohen për subjektet e ligjit dhe çështjet specifike (p.sh sistemi parandalues, rregulloret dhe procedurat e brendshme, personi përgjegjës, vlerësimi i rrezikut PP/FT, zbatimi i sanksioneve ndërkombëtare);
- Aktivitetet informuese me grupet e biznesit dhe shoqatat e subjekteve të ligjit;

Efektet e keqinformimit

Shpërndarja e shpejtë e informacionit përmes platformave dixhitale, ka revolucionarizuar mënyrën se si i marrim dhe interpretojmë lajmet dhe informacionin, në të gjitha fushat e jetës, veçanërisht në ato që lidhen me aspektet shoqërore, aktivitetin politik, fushën e ekonomisë dhe financave etj.

Interneti ka transformuar aspekte të ndryshme të jetës së përditshme, duke përfshirë mënyrën

se si individët kryejnë transaksione financiare dhe marrin shërbimet nga institucionet shtetërore. Qasja në platformat bankare, investuese dhe tregtare gjithashtu e kanë bërë më të lehtë për individët njohjen dhe konsultimin me informacionin financiar.

Ky niveli i shtuar i informacionit shumëplanësh, është shoqëruar gjithashtu me një përhapje shqetësuese të lajmeve keq informuese, të cilat mund të kenë pasoja të dëmshme për individët, tregjet dhe në përgjithësi për ekonominë e një vendi.

Keqinformimi, nënkupton përhapjen e informacionit të rremë ose të pasaktë, shpesh pa dashje, duke çuar në një keqinterpretim të fakteve ose ngjarjeve. Ai mund të lindë nga burime të ndryshme, si gabimi njerëzor ose të dhëna jo të plota, duke u bazuar shpeshherë në pretendime të rreme dhe përmbajtje mashtruese.

Nga ana tjetër, keqinformimi në fushën ekonomiko-financiare ka të bëjë në mënyrë më specifike me shpërndarjen e lajmeve të rreme apo informacioneve mashtruese, në lidhje me çështjet financiare, me qëllim të manipulimit të tregjeve, investitorëve ose sistemeve financiare për përfitime personale duke u bazuar në këshilla të rreme për investime, manipulimi i pasqyrave financiare, ose skemat mashtruese që synojnë individët apo institucionet.

Edukimi dhe ndërgjegjësimi i publikut për rreziqet që vijnë nga kjo veprimtari keq informuese, synon që nëpërmjet identifikimit të llojit të lajmeve dhe burimeve të tyre të vlerësojë dhe ndikimet përkatëse.

Bazuar në përvojën ndërkombëtare, keqinformimi ndër të tjera mund të çënojë funksionimin e tregjeve, të dëmtojë interesat e ligjshme të investitorëve vendas apo të huaj dhe të ulin besimin e publikut tek institucionet financiare

Strategjitë e zbulimit dhe zbutjes së hershme shërbejnë për të mbrojtur investitorët, rritjen e transparencës së tregut dhe ruajtjen e stabilitetit financiar. Në këtë kontekst ndërgjegjësimi dhe edukimi i publikut është i një rëndësie të veçantë për ndërmarrjen e masave që synojnë parandalimin apo zbutjen e pasojave negative të këtyre fenomeneve në jetën ekonomike shoqërore në vend.

Bazuar në përvojën e vendeve të zhvilluara individët me nivele më të larta të njohurive (përfshirë ato ekonomiko-financiare) kanë shfaqur një nivel më të lartë mbrojtje ndaj ndikimit të lajmeve të rreme financiare, duke nxjerrë në pah rëndësinë që edukimi financiar mund të ketë si një strategji efektive për të luftuar këtë fenomen.

Përdorimi i Teknologjive të Reja (Fintech)

Zhvillimi me ritme të shpejta i teknologjive të reja financiare (Fintech) kanë sjellë një ndryshim në mënyrën e ndërveprimit të individëve me shërbimet financiare, gjë e cila ka ndikuar në

mënyrë të drejtpërdrejtë në sofistikimin e metodave të përdorura për pastrimin e produkteve të veprës penale dhe financimit të terrorizmit. Produktet e Fintech kanë sjellë një sërë risish në sektorin financiar duke nisur që nga rritja e efikasitetit, uljen e kostove, rritjen e shpejtësisë së veprimeve financiare, zgjerimin e aksesit, rritjen e anonimitetit, rritjen e kategorisë së shërbimeve, etj., ndërkohë që për institucionet përgjegjëse për hetimin/parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit ka sjellë sfida të reja në zbulimin dhe parandalimin e aktiviteteve kriminale.

Marrë shkasë se në Shqipëri përdorimi i teknologjive të reja financiare (Fintech) për kryerjen e veprimeve financiare është në fazat e fillimit, është e rëndësishme që publiku i gjerë të njihet me konceptet e Fintech me qëllim që të mos bien pre e mashtrimeve apo të keqpërdoren nga persona të tretë për kryerjen e veprimtarive të paligjshme/ kriminale.

Çfarë nënkuptojmë me Fintech:

Teknologjia financiare (e njohur ndryshe si Fintech) i referohet teknologjive të reja që synojnë përmirësimin dhe automatizimin e përdorimit dhe ofrimit të shërbimeve financiare. Në kategorinë e Fintech përfshihen të gjitha platformat digjitale të cilat ofrojnë:

- Platforma investimi pa prezencë fizike (non-face to face);
- Platforma të transferimit të parave pa prezencë fizike (*non-face to face*);
- Platforma/subjekte të parasë elektronike;
- Platforma të portofolit digjital (*digital wallets*);
- Mjetet virtuale (njohur ndryshe edhe si kriptomonedha/kripto valuta)
- Internet Banking;
- Mobile Banking;
- Platforma për mbledhjen e fondeve (*Crowdfunding*).

Rritja e Sigurisë në Përdorimin e Fintech

Në këtë kontekst synohet të rritet niveli i ndërgjegjësimit të publikut për mbrojtjen nga mashtrimet dhe abuzimet për Pastrimin e Parave dhe Financimin e Terrorizmit.

- **Njohja e Platformës dhe Shërbimit:** Para se të përdoret një platformë Fintech, duhet të sigurohemi që të jetë e licencuar dhe të ketë një reputacion të mirë. Të kryhen verifikime në burime të hapura për vlerësimet nga përdorues të tjerë, si dhe informacionin e ofruar nga autoritetet rregullatorë.
- **Kontrolli i vazhdueshëm i llogarive financiare:** Monitorimi i rregullt i veprimeve në llogari me qëllim identifikimin në kohë të transaksioneve të dyshimta ose të paautorizuara.
- **Shmangia e propozimeve të dyshimta për investim:** Platformat e Fintech shpeshherë përdoren nga individë të përfshirë në veprimtari të paligjshme/kriminale dhe një nga skemat më të përdorura vitet e fundit janë edhe mashtrimet nëpërmjet platformave të investimit ku premtohen mundësi fitimi të shpejta apo investime për krijimin e bizneseve të reja. Para këtyre lloj investimesh duhet të sigurohet më tepër informacion.

- **Përdorimi i platformave të licencuara/rregulluara:** Para përdorimit të platformave Fintech, sigurohuni që ato të jenë të licencuara dhe të rregulluara në vendet ku ushtrojnë aktivitetin. Po ashtu, nëse platforma ushtrojnë aktivitet në një vend ndryshe nga ai ku kanë marrë licencën, sigurohuni që ajo të jetë e njëjta platformë dhe mbikëqyret në përputhje me legjislacionin kundër pastrimit të parave, financimit të terrorizmit si dhe mashtrimeve.
- **Verifikimi i platformave për mbledhjen e fondeve para kryerjes së donacioneve:** Është e rëndësishme verifikimi i platformave për mbledhjen e fondeve para se të kryhen donacione për kauza të caktuara, pasi shpeshherë këto platforma krijojnë mundësi abuzimi përfshirë edhe mbështetjen e financimit të aktiviteteve mbështetës të grupeve terroriste.
- **Përdorimi i korrierëve (Money Mule)⁴ pa dijeni për pastrim parash:** Rritja e përdorimit të mjeteve virtuale dhe mundësitë që ato ofrojnë për transaksione nga një përdorues tek një tjetër (për-to-për), si dhe anonimiteti që sigurojnë, mund të krijojnë mundësi për abuzime. Shpesh, individët ose subjektet mund të përdoren si korrier pa dijeninë e tyre, duke transferuar para të fituara në mënyrë të paligjshme përmes mjeteve virtuale. Këta individë mund të veprojnë si ndërmjetës, duke mbajtur dhe transferuar fonde për të marrë një komision ose përfitime nga investime të caktuara, pa pasur njohuri për burimin e paligjshëm të parave që po transferojnë.

Grupet e synuara dhe prioritetet

Nëpërmjet procesit të ndërgjegjësimit të publikut për çështje të PP/FT ka si synim për:

- Të shpjeguar konkretisht pasojat që ka paraja me burim kriminal në jetën sociale, ekonomi dhe politikë - në luftë kundër konceptit se ‘në fund të fundit janë para që hyjnë në Shqipëri dhe investohen këtu dhe se kështu është zhvilluar gjithë bota’;
- Të sqaruar publikun e gjerë mbi rrezikshmërinë e kësaj veprë në aspektin e risqeve të përfshirjes në të (psh shumë kush pa patur prirje aktive kriminale, mund të transportojë para cash për të tretë pa qenë i ndërgjegjshëm se po kryen një krim apo se mund të jetë duke kryer një krim; ose shumë kush mund të pranojë fonde me burim të errët për zhvillimin e biznesit të tij pa qenë i ndërgjegjshëm se është përfshirë në pastrim parash; ose shumë kush mund të pranojë të krijojë kompani për të tretë pa qenë i ndërgjegjshëm që mund të jetë duke u përfshirë në pastrim parash etj.);
- Të sqaruar publikun për masa AML, pasi: gama e subjekteve raportuese të të gjitha llojeve në fakt tregon se janë një ushtri me qytetar që janë ose do punësohen në këto subjekte raportuese të cilët kanë detyrim ligjor njohjen e zbatimin e legjislacionit për parandalimin e pastrimit të parave; evidentojmë se subjekt raportues janë edhe institucionet shtetërore që tjetërsojnë pronën shtetërore, por që nuk kanë struktura e madje as njohuri për detyrimet që kanë, që d.m.th. është shumë i gjerë numri i punonjësve që përfshihen në këtë veprimtari të tjetërsimit të pronës shtetërore;
- veç kësaj me ndryshimet e fundit në ligjin për parandalimin e PP/FT janë subjekt raportues kur kryejnë pagesa cash.

⁴ është një term që përdoret për të përshkruar një individ që transferon ose merr para të fituara në mënyrë të paligjshme nga një llogari në tjetrën, shpesh pa pasur dijeni për burimin kriminal të fondeve.

Duke qenë se pastrimi i parave lidhet edhe me korrupsionin, ndërgjegjësimi për PP/FT ka ndikim dhe në luftën kundër korrupsionit.

Grupet që synohet të ndërgjegjësohen mbi rreziqet e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit janë qytetarët në përgjithësi, por ndër më prioritarët janë:

- **Të rinjtë** duke filluar nga gjimnazistët në përgjithësi, e duke vijuar më specifikisht me të rinjtë që studiojnë në shkenca si, **ekonomia, drejtësia, administrim, politika sociale, etj.**, në mënyrë që gjatë procesit të formimit të tyre të informohen mbi rrezikun që mbart për shoqërinë në përgjithësi futja e parave që janë rezultat i aktiviteteve kriminale në ekonomi, por dhe me gjasë që, t'ju shërbejë atyre për të qenë më të kualifikuar kur të jenë aktiv qoftë në sektorin publik apo privat për të identifikuar dhe parandaluar fenomenin, etj.;
- **Punonjësit e administratës publike** në përgjithësi, pasi janë një grup i rëndësishëm që duhet të ndërgjegjësohen mbi rreziqet e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit dhe masat që duhen marrë për parandalimin e tyre. Rëndësi të veçantë në këtë grup kanë punonjësit e doganave, tatimeve, zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, bashkisë etj., pasi ato janë direkt në kontakt me aktivitetet ekonomike dhe financiare nëpërmjet të cilave personat që kryejnë veprimtaritë kriminale kalojnë, etj.;
- **Punonjësit e autoriteteve ligj zbatuese (prokurorë, hetues, gjyqtarë etj.)**, pasi ata luajnë një rol thelbësor në zbulimin, hetimin dhe ndjekjen e rasteve që lidhen me pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit, duke u trajnuar dhe informuar në mënyrë vijuese për të rejat dhe dinamikën e tipologjive, udhëzimeve dhe standardeve ndërkombëtare, i ndihmon ata në punën e tyre të përditshme, etj.;
- **Punonjësit në përgjithësi të subjekteve raportuese sipas ligjit** apo personat përgjegjës të caktuar për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit si në zyrat qëndrore apo në çdo zyrë përfaqësimi, duke filluar nga punonjësit e bankave, Institucionet Financiare Jo Banka (IFJB), shoqëritë e kursim kreditit (shkk), zyrat e këmbimit valutor (zkv), noterë, avokatë, auditues, agjentët e pasurive të paluajtshme, etj.. Këta punonjës në përgjithësi apo përfaqësues të caktuar nga subjektet raportuese (*të cilët duhet të raportojnë çdo fakt që mund të përbëjë dyshim për pastrim parash ose financim terrorizmi*) duhet të jenë të informuar dhe trajnuar që të përmbushin me korrektësi detyrën e tyre pavarësisht subjektit ku janë të punësuar (*publik apo privat*) në lidhje me PP/FT;
- **Punonjësit e subjekteve të tjera të komunitetit të biznesit në përgjithësi**, pasi biznesi është një shtyllë e rëndësishme për ekonominë e një vendi si krijues vendesh pune, të ardhurash dhe me kontribut në zhvillimin dhe rritjen e ekonomisë në përgjithësi. Si të tilla, bizneset janë të ekspozuara nga rreziqet e PP/FT, kështu që, informimi dhe edukimi sa më i plotë i punonjësve që punojnë në këto biznese pavarësisht objektit të tyre, rrit standardin e përpjekjeve dhe barrierave që duhet t'i vendosen këtij fenomeni kriminal, që në thelb prish rregullat se si bëhet biznes i ndershëm, etj.;
- **Sipas rastit çdo subjekt apo institucion i interesuar** që lidhet apo mund të cënohet eventualisht nga këto fenomene të paligjshme dhe kriminale dhe për të cilat vlerësimi i nevojës për informim, ndërgjegjësim do të vlerësohet në vijim.

Ndërgjegjësimi i këtyre grupeve nëpërmjet informimit, debateve publike, edukimit akademik, trajnimeve vazhduese, etj., ka si qëllim të ndikojnë në uljen e rrezikut të PP/FT në vendin tonë.

Në kuadër të kësaj veprimtarie ndërgjegjësuere-edukuese e vlerësojmë si të përshtatshme dhe me impaktin e nevojshëm këto lloj aktivitetesh:

- Takime me organizata përfaqësuese biznesi dhe diskutim i hapur mbi problemet që lidhen me PP/FT e hapat që duhen ndërmarrë për të identifikuar problemet dhe shmangur pasojat;
- Takime me studentë nëpër auditorë, ku krahas përmirësimit të kurrikulave të tyre, kryerjen edhe të leksioneve të hapura me tema mbi PP/FT;
- Takime me maturan të me qëllim që edukata qytetare si lëndë e tyre në formimin e mesëm të ketë vend edhe për tema të caktuara ku flitet dhe edukohen me atë që quhet PP/TF;
- Takime me punonjës të Administratës Qendrore dhe Lokale me qëllim sensibilizimin dhe angazhimin e tyre në përpjekjet për evidentimin dhe pengimin e PP/FT;
- Inicimin për zhvillimin e debateve të ndryshme televizive me tema mbi PP/FT me qëllim evidentimin e problemeve që krijohen në ekonomi e në shoqëri në tërësi, si dhe, rrugët e daljes apo përmirësimit të punës të agjencive ligj zbatuese dhe operatorëve të ndryshëm privat e publik në treg;
- Inicimin e shkrimeve problematike apo editorialeve të ndryshme në media qoftë të shkruara apo edhe elektronike me tema mbi PP/FT;
- Publikimin e rasteve të ndryshme të skemave se si kryhet PP/FT qoftë nisur nga rastet dhe përvoja e vendit tonë por dhe nga përvoja e vendeve të tjera;
- Përgatitja dhe shpërndarja e fletë palosjeve apo njoftimeve të ndryshme në rrjetet sociale mbi bazën ligjore në fuqi, detyrimet e individëve dhe subjekteve për të konstatuar dhe raportuar si dhe dëmet që i vinë shoqërisë nga PP/FT;

Kanalet e komunikimit dhe aktivitetet

Komunikimi për edukimin mbi rreziqet e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit mund të realizohet nëpërmjet:

- **Medias** (televizion, radio, podcast etj.) komunikime me grupe gazetarësh me impakt në fushën ekonomike;
- **Rrjeteve sociale** (facebook, twitter, linkedin etj.), nëpërmjet shpërndarjes së informacioneve edukative mbi PP/FT;
- **Krijimi i platformave informative** me artikuj, video dhe materiale mbi temat e PP/FT;
- **Trajnime, workshope, posta elektronike (email);**
- **Partneriteti me sektorin privat dhe organizata jo qeveritare** për të organizuar aktivitete edukative mbi PP/FT;
- **Publikime periodike (news letter)**, në të cilën përfshihen të dhënat statistikore apo të dhënat për tipologji dhe tregues, si dhe aktivitetin institucional në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar;

- **Publikimi i pyetjeve më të shpeshta;**
- **Takime të GTNP me institucionet shtetërore dhe grupet e interesit;**
- **Koordinimi i punës për zbatimin e dokumenteve strategjik;**

Shembuj komunikimi me grupet specifike

Shembull 1

Informacioni për publikun e gjerë nuk është e nevojshme të jetë i detajuar por do të ishte e mjaftueshme të njihet me legjislacionin, të dhëna të përgjithshme për detyrimet ligjore të subjekteve financiare dhe profesioneve të lira, transaksionet me para në dorë dhe detyrimi për raportimin e tyre.

Në njoftimet për publikun e gjerë, ndryshimet ligjore mund të promovohen duke përdorur “mesazhe pozitive” (p.sh rritja e transparencës për pronarët përfitues të personave juridik, masat kundër korrupsionit që lidhen me vigjilencën e zgjeruar ndaj personave të ekspozuar politikisht, mbikëqyrje e bazuar mbi riskun dhe përdorimi efektiv i burimeve njerëzore të institucioneve publike dhe private në zbatim të legjislacionit PPP/FT, reduktimi i transaksioneve me para në dorë, rritja e shërbimeve bankare që ndikojnë në zgjerimin e klientelës dhe uljen e kostos së transfertave, transparencë në financimin e partive politike dhe shmangien e konfliktit të interesit etj.).

Shembull 2

Grupi i synuar “ekspertët e përputhshmërisë” së bankave dhe instituteve të tjera financiare. Informacioni për këtë grup duhet të jetë më i detajuar dhe në këtë kontekst institucionet:

- Mund të ofrojnë trajnime periodike për personat përgjegjës të përputhshmërisë;
- Informojnë në mënyrë të vazhdueshme mbi çështjet praktike të zbatimit të legjislacionit PPP/FT;
- Përditësojnë rregullisht informacionin mbi pyetjet më të shpeshta dhe informacione të tjera mbi çështjet praktike;
- Ofrojnë udhëzime për subjektet e obliguara për kryerjen e trajnimeve të brendshme, kontrollin e listës së personave të shpallur si financues të terrorizmit nga OKB, detyrimin për identifikimin e pronarit përfitues, zbatimin e masave për vigjilencën e zgjeruar;

Rezultati i pritshëm

- Aktivitetet e komunikimit do të përqendrohen kryesisht në institucionet financiare dhe kategoritë e profesioneve të lira sipas nivelit të ekspozimit ndaj rreziqeve PP/FT;
- Procesi i komunikimit çon në rritjen e kapaciteteve parandaluese të subjekteve (p.sh. kthimin në kohë të përgjigjeve për informacion, rritja sasiore dhe cilësore e raportimit, forcimi i bashkëpunimit në kuadrin e partneriteteve publike private);
- Një faktor tjetër i rëndësishëm për rritjen e ndërgjegjësimin për ligjin PPP/FT është sigurimi i materialeve informative për klientët e institucioneve financiare;

Aktivitetet vijuese që institucionet mund të kërkojnë nga subjektet e ligjit PPP/FT:

- Të njihen me ndryshimet ligjore në fushën e PPP/FT;
- Personat përgjegjës përfshijnë informacionin për ndryshimet ligjore në seancat e trajnimit për punonjësit;
- Rishikimi i vazhdueshëm i sistemeve të automatizuara, sinjalizimet e përfituara dhe përshtatja e tyre me skenarët e rrezikut të identifikuar nga subjektet;
- Rishikimi i rregulloreve dhe procedurave të brendshme;
- Përgatitja e fletëpalosjeve informative për klientët, me të dhëna mbi detyrimet e ligjit PPP/FT.

Monitorimi dhe vlerësimi

Zbatimi efektiv i kësaj strategjie, bazohet në një kuadër të qëndrueshëm për mbikëqyrjen dhe vlerësimin e vazhdueshëm të objektivave përkatës. Ky kuadër do të mundësojë gjurmimin e përparimit në kohë, përcaktimin e pengesave dhe vlerësimin e ndikimit të aktiviteteve në rritjen e ndërmjetësimit të institucioneve, subjekteve të ligjit dhe publikut të gjerë. Raportet e mbikëqyrjes do të shërbejnë si një bazë për planifikimin e aktiviteteve të ardhshme nga institucionet e përfshira.

Për vlerësimin e zbatimit të objektivave të kësaj strategjie GTNP, do të zhvillojë, mbajë dhe ndjekë ecurinë e projekteve të edukimit në fushën e PPP/FT dhe programeve të lidhura me to dhe do të monitorojë një sërë rezultatesh për të siguruar efektivitetin e procesit.

Ky vlerësim do të bazohet në treguesit e mëposhtëm:

- Numri i subjekteve të ligjit të përfshira në programet e trajnimeve të PPP/FT-së dhe personat pjesëmarrës. Publikimet përkatëse duhet të shfaqen në faqet zyrtare të institucioneve;
- Numri i institucioneve shtetërore të përfshira në programet e informimit, trajnimit të PPP/FT dhe personat pjesëmarrës. Publikimet përkatëse në faqen zyrtare të institucioneve;
- Numri i intervistave apo konferencave me pjesëmarrjen e institucioneve dhe publikimet përkatëse në faqen zyrtare të institucionit;
- Aktivitetet e organizuara në institucionet arsimore dhe numri i pjesëmarrësve;
- Publikimet e tipologjive dhe treguesve të PP/FT në faqen zyrtare të institucioneve;
- Publikimi i raportit vjetor të institucioneve;
- Konferenca për shtyp të organizuara në kuadrin e raporteve të publikuara në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar;
- Rezultatet e vrojtimeve apo anketimeve në lidhje me efektshmërinë e aktiviteteve të këtij udhërrëfyesi;
- Sondazhet që mund të realizohen me grupet që synohen të ndërgjegjësohen;

- Krijimi i mekanizmave të komunikimit me publikun me qëllim informimin për çështjet që konsiderohen prioritare;
- Numri i takimeve të organizuara me grupet përkatëse, rritja e numrit të personave pjesëmarrës, prezantimet që realizohen për këtë qëllim.

ANEKS I:
PLANI I VEPRIMIT PËR ZBATIMIN E STRATEGJISË SË KOMUNIKIMIT

Objektivi 1: Sensibilizimi i opinionit publik mbi rrezikun që mbart pastrimi i parave dhe financimi i terrorizimit në shoqërinë tonë.			
Nr.	Masat	Institucionet përgjegjëse	Afati
1.1	- Publikimin e të dhënave (dhe inkurajimin e publikimit të të dhënave nga çdo individ, institucion publik apo privat) që lidhen me problemet që kanë sektorë të ndryshëm të ekonomisë dhe të shoqërisë në tërësi, nga pastrimi i parave apo financimi i terrorizmit.	Anëtarët e GTNP	Prill 2025
1.2	- Inkurajimin e shkrimeve dhe publikimeve analitike apo problematike nga studiues në këtë fushë.	Anëtarët e GTNP	Qershor 2025
1.3	- Publikimi i rasteve dhe tipologjive të ndryshme që lidhen me pastrimin e parave apo financimin e terrorizmit që janë siguruar nga hetimet penale apo hetimet pasurore.	Anëtarët e GTNP	Mars 2025
1.4	- Bashkëpunimi me media të ndryshme me qëllim programimin dhe zhvillimin e emisioneve televizive mbi problematikat që mbart pastrimi i parave dhe financimi i terrorizimit.	Anëtarët e GTNP	Qershor 2025
Objektivi 2: Edukimi që duhet të marrin nxënësit dhe studentët gjatë formimit të tyre akademik			
Nr.	Masat	Institucionet përgjegjëse	Afati
2.1	- Vlerësimi i mundësive që kurrikulat e gjimnazeve apo kolegjeve në vendin tonë të kenë vend që të trajtojnë një ose disa tema mbi rrezikun që mbart për ekonominë dhe zhvillimin e shtetit të së drejtës futja e parave të siguruar nga aktiviteti kriminal në ekonomi.	Anëtarët e GTNP	Prill 2025
2.2	- Vlerësimi i mundësive që kurrikulat e fakulteteve të profileve që lidhen me ekonominë, drejtësinë, administrimin, politikën sociale, etj., të parashikojnë lëndë mësimore apo grup të përqëndruar leksionesh apo temash, konkretisht ato që kanë të bëjnë me pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit (ku të trajtohen	Anëtarët e GTNP	Qershor 2025

	gjerësisht çfarë është pastrimi i parave dhe financimi i terrorizmit, format e shfaqjes së tyre, rreziqet eventuale që sjellin për ekonominë dhe shoqërinë në tërësi, legjislacioni në fuqi, eksperiencia ndërkombëtare, operatorët dhe agjencitë përgjegjëse, subjektet, etj.).		
2.3	- Vlerësimi i mundësive që të orientohen programet e masterave nëpër fakultete që kanë profilet e të drejtës penale dhe krimin të organizuar, që të fokusohen me lëndë apo grupe të përqëndruara leksionesh apo temash, konkretisht ato që kanë të bëjnë me pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit, duke bërë parashtrime të zgjeruara.	Anëtarët e GTNP	Prill 2025
2.4	- Nxitja e trajtimit të temave të kurseve apo diplomave të fakulteteve e masterave, apo dhe doktoratura me tema që lidhen me pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit me qëllim që kjo fushë të njohë dhe trajtim sa më të madh akademik, etj.	Anëtarët e GTNP	Qershor 2025
Objektivi 3: Trajnimi vazhdues i hetuesve, prokurorëve, gjykatësve e çdo subjekti tjetër që ka në fokus të tij evidentimin dhe ndjekjen e rasteve që lidhen me pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit			
Nr.	Masat	Institucionet përgjegjëse	Afati
3	- Zbatimi i planit vjetor të trajnimit për vitin 2025.	Anëtarët e GTNP	Brenda vitit 2025
Objektivi 4: Trajnimi i komunitetit të biznesit dhe administratës publike me qëllim identifikimin e veprimtarive të dyshimta financiare dhe përdorimin e materialeve edukative mbi parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit duke përdorur broshura, udhëzues etj..			
Nr.	Masat	Institucionet përgjegjëse	Afati
4.1	- Takim dhe trajnim në bashkëpunim me Dhomën Kombëtare të Tregtisë.	AIF	Prill 2025
4.2	- Bashkëpunim me Shkollën Shqiptare të Administratës Publike për informimin e nëpunësve për parandalimin e pastrimit të parave, financimit të terrorizmit.	AIF	Qershor 2025

Aneks II: Pyetësor

Pyetësor për pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit

Pjesa I: Informacione Personale

- a) Mosha;
- b) Gjinia;
- c) Arsimi;
- d) Puna aktuale;

Pjesa II: Njohuri mbi PP/FT

1. A keni njohuri mbi pastrimin e parave?
 - a) Po
 - b) Jo
2. A e dini se cili është qëllimi i pastrimit të parave dhe efektet në sistemin ekonomiko-financiar të vendit?
 - a) Po
 - b) Jo
3. Cilat janë disa nga metodat që përdoren në fushën e pastrimit të parave? (shënoni të gjitha që zbatohen)
 - a) Depozitime me para në dorë në llogari bankare, poshtë pragut të raportimit;
 - b) Përdorimi i kompanive guackë dhe në vendet që njohen si parajsë fiskale;
 - c) Investime në pasuri të paluajtshme;
 - d) Transferta ndërkombëtare;
 - e) Pagesat me mjete virtuale;
 - f) Të tjera: _____
4. A e dini se cili është qëllimi i financimit të terrorizmit dhe cilat janë efektet e tij në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar?
 - a) Po
 - b) Jo
5. Cilat janë disa burime të zakonshme të financimit të terrorizmit? (shënoni të gjitha që zbatohen)
 - a) Donacione individuale;

- b) Të ardhura nga aktivitete të jashtëligjshme;
- c) Aktivitetet legjitime të biznesit;
- d) Fondet e organizatave bamirëse;
- e) Të tjera: _____

6. Sa të rrezikshme i konsideroni këto aktivitete për shoqërinë?

- a) Shumë të rrezikshme;
- b) Të rrezikshme;
- c) Pak të rrezikshme;
- d) Aspak të rrezikshme;

Pjesa III: Veprimet dhe Politikat

7. A besoni se institucionet financiare po bëjnë mjaftueshëm për të parandaluar pastrimin e parave në Shqipëri?

- a) Po
- b) Jo
- c) Nuk kam informacion

8. A keni konstatuar raste që mund të jenë të lidhura me pastrimin e parave dhe krimin e organizuar?

- a) Po
- b) Jo

9. Sa të informuar jeni për rolin e Agjencisë së Inteligjencës Financiare dhe procedurat për raportimin e aktiviteteve të dyshimta?

- a) Shumë të informuar;
- b) Të informuar;
- c) Pak të informuar;
- d) Aspak të informuar;

10. Çfarë masash mendoni se duhen marrë për të luftuar pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit?

- a) Edukim më të gjerë për qytetarët;
- b) Rregulla më të rrepta për institucionet financiare;
- c) Rritja e bashkëpunimit ndërkombëtar;
- d) Të tjera: _____;

11. A mendoni që dokumentet strategjik të miratuar në Shqipëri janë efektiv për adresimin e rreziqeve që lidhen me pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit në Shqipëri?

a) Po

b) Jo

Pjesa IV: Sugjerime dhe Komente

12. Cilat janë disa sugjerime që keni për të rritur ndërgjegjësimin mbi këto çështje?

13. Keni ndonjë koment tjetër lidhur me këtë temë?